

	KOMENTE	FO-ÇLRR-025
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 1 nga 3</i>

13.06.2014

Komente lidhur me: Raportin Konsultativ për SHTE 8

Çështja për komentim:

*Faktori i Efikasitetit
Shërbimet Ndihmëse*

Komentimi:

Hyrje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë si pjesë procesit të Shqyrtimit të Tetë të Tarifave të Energjisë Elektrike për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike (FPEE) dhe Përshtatjet e Rregullta për Vitin e Dytë Relevant të SHTE7 të Shqyrtimit Tarifor për Gjeneratorët e Rregulluar (KEK), Operatorin Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) ka lëshuar Raportin Konsultativ për Kalkulimin e MAR-it të KOSTT-it për Vitin Relevant 2.

KOSTT, pas analizës së këtij raporti dhe çështjeve që i prek ky raport, në vijim ka paraqitur komentet dhe qëndrimet e veta.

Faktori i Efikasitetit

Në procesin e Shqyrtimit të Shtatë të Tarifave – SHTE 7, Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka vendosur aplikimin e faktorit të efikasitetit prej 4% ndaj Shpenzimeve Operative të KOSTT. Gjatë gjithë procesit të SHTE 7 si dhe në Aplikacionin për SHTE 8, KOSTT vazhdimisht ka parashtruar kërkesën për zvogëlimin e këtij faktori duke e arsyetuar me fakte të qëndrueshme teknike dhe financiare. ZRrE në këtë Raport Konsultativ ka vazhduar të mbajë qëndrimin e njëjtë lidhur me këtë faktor duke mos e ndryshuar nivelin e tij.

KOSTT mbetet mjaft i shqetësuar nga ky qëndrim duke u nisur nga fakti se arritja e kësaj eficiency është praktikisht e pamundur. Pamundësia e arritjes së këtij niveli të efikasitetit bazohet nga fakti se KOSTT është një nga kompanitë më eficiente në Rajon e më gjerë. Eficiency teknike e KOSTT ku parametrat kryesorë matës janë humbjet në transmision, siguria në furnizim, operimi i sistemit e vendosin kompaninë në një nivel të lakmueshëm për

të gjitha kompanitë e transmisionit në rajon. Këto parametra kanë një kufi që fizikisht nuk mund të arrihet më shumë. Parametrat financiarë që gjithashtu e mbështesin këtë nivel janë, paga mesatare e cila është më e ulëta në rajon, tarifa mesatare më e ulëta në rajon, shpenzimet e mirëmbajtjes ndër më të ulëtat në rajon, etj.

Vazhdimi i zvogëlimit të shpenzimeve operative nuk paraqet mëtej efikasitet por dëmtim financiarë të kompanisë.

Siç e kemi cekur edhe më herët një mesatare e rritjes së efikasitetit përgjithësisht në sektorin e energjisë në shtetet e Evropës duket të jetë 2.9%. Andaj duke marrë parasysh nivelin e zhvillimit në shtetet evropiane dhe në Kosovë, niveli prej 2.9% është nivel shumë i lartë, për një kompani që operon dhe zhvillohet në Kosovë.

KOSTT përveç nivelit të lartë të faktorit të efikasitetit, konsideron shqetësuese edhe aplikimin e këtij faktori ndaj të gjitha kategorive të shpenzimeve operative, pavarësisht zhvillimit të kompanisë dhe rritjes së efektivitetit. Disa kategori të shpenzimeve operative janë shpenzime që gjithmonë kanë trend të rritjes. Këtu mund të përmendim shpenzimet e personelit të cilat me zhvillimin e kompanisë dhe rritjes së standardeve rriten, për shkak se pagat e larta janë reflektim i efikasitetit të lartë teknike dhe financiare. Gjithashtu edhe tek shpenzimet tjera ka nën kategori që janë gjithmonë në rritje për ta përcjellë rritjen e kompanisë.

Andaj, aplikimi i faktorit vetëm ndaj disa kategorive operative duket së është më i drejtë dhe i përshtatshëm se sa ndaj të gjitha shpenzimeve operative.

Shërbimet Ndhmëse

Në Raportin Konsultativ ZRrE ka përmendur vlerën prej 1.6 milionë €, që është kërkuar nga KOSTT për shërbimet ndihmëse. KOSTT dëshiron të sqarojë se vlera e llogaritur prej 1.6 milionë €, ka paraqitur supozimet vetëm për shpenzimet e Rregullimit Sekondarë, kurse për shpenzimet e Rregullimit Terciarë nuk janë paraqitur për hir të korrektesisë pasi që vlerën e këtyre shërbimeve e cakton tregu andaj edhe parashikimi i tyre mund të ketë ndryshime të mëdha nga realiteti. Mirëpo, këto shpenzime gjithashtu do të fillojnë të realizohen në momentin e nënshkrimit të kontratës me EMS (Serbi).

Sa i përket të hyrave nga tranziti dhe alokimi i kapaciteteve, përshtatja e këtyre të hyrave me shpenzimet e shërbimeve ndihmëse mund të bëhet vetëm me të hyrat nga tranziti të cilat janë kosto kaluese në KOSTT, kurse të hyrat nga alokimi i kapaciteteve janë të hyra që dedikohen për zhvillimin e kapaciteteve të reja transmetuese dhe nuk janë kosto kaluese për kompaninë.

ZRRE duhet të zotohet se kostot e rregullimit terciar do të reimbursehen (agjustohen) nëse KOSTT mandatohet që do ta ekzekutoj kontratën e shërbimeve ndihmëse për vitin 2014. .

Përmbledhje

Nga propozimet e paraqitura në Raportin Konsultativ, ZRrE parasheh që shpenzimet operative që do të përfshihen në MAR-in e vitin 2014 janë 7.1 milionë €. Parashikimet e KOSTT për realizimin e këtyre shpenzimeve për vitin 2014 janë 8.7 milionë €, ashtu siç është paraqitur edhe kërkesa për këto shpenzime në aplikacionin për SHTE 8. Mungesa prej 1.6 milionë € që pritet të paraqitet në fund të vitit do të krijojë vështirësi për kompaninë. I vetmi burim që KOSTT mund ta shfrytëzojë për këtë mungesë mund të konsiderohet fitimi që i paraqitet kompanisë nga kursimet e viteve të mëparshme.

Përgatitur nga: Sektori i Tarifave, Departamenti për ÇLRr